

**KONTRATË**  
**SHIT – BLERJE KUOTE**

Sot, më datë 23/05/2023 (dymijë e njëzet e tre), Shitësi dhe Blerësi, ranë dakord për hartimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje Kuote me termat e mëposhtme:

- SHITËSIT:** **DIJON ALBANIA Sh.a.**, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër identifikimi NIPT K81805011P, me seli në TIRANE Njesia bashkiake nr 2, Sheshi “Avni Rustemi”, Vila 3-kateshe (ish vila e Vefes), përfaqësuar nga Administratori Zj. Silvana Pashako.
- BLERËSI:** **ALAR Consulting Sh.p.k.** shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër identifikimi NIPT L71312045T, me seli në TIRANE Rruga “Donika Kastrioti”, Pallati nr. 8, kati 3, Apartamenti nr. 2/3, Tiranë përfaqësuar nga Administratori Z. Astrit Hana.

**KUSHTE PARAPRAKE**

Shoqëria Tregtare **ITALDRURI ELBASAN Sh.p.k.** është themeluar më datë 10/09/1993 dhe regjistruar me datë 01/07/1996 në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me nr. NIPT J62903222L.

Shoqëria ka një kapital themeltar të regjistruar prej 1.497.049.087 (një miliard e katërqind e nëndhjetë e shtatë milion e dyzet e nëntëmijë e tetëdhjetë e shtatë) Lekë, i ndare në 2 kuota të zotëruara nga Ortakët si vijon:

1. **Shoqëria DIJON ALBANIA Sh.a.**, e cila zotëron 81,93% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë.
2. **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**, i cili zotëron 18,07% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë.

Ortaku DIJON ALBANIA Sh.a., i cili zotëron 81,93 % të kapitalit të shoqërisë dëshiron të tjetërsojë një pjesë të kapitalit që zotëron.

Me vendimin datë 16/05/2023, ortaku DIJON ALBANIA Sh.a., ka vendosur të miratojë shitjen e 17.6 % të kuotave të zotëruara nga Shoqëria në kapitalin e shoqërisë **ITALDRURI ELBASAN sh.p.k tek blerësi ALAR Consulting sh.p.k. për një çmim prej 263,550,000 Leke.**

Me shkresën nr.9073/2 prot. datë 23/05/2023 ortaku Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vendosur të miratojë pikën 3 të rendit të ditës “Transferimi tek shoqëria **ALAR Consulting Sh.p.k. i 17.6 % të kapitalit që ortaku DIJON ALBANIA Sh.a zotëron në shoqërinë ITALDRURI ELBASAN sh.p.k.**”.

Me vendimin datë 23/05/2023, Asambleja e ortakëve të shoqërisë ITALDRURI ELBASAN sh.p.k ka vendosur të miratojë shitjen nga DIJON ALBANIA Sh.a., të kuotës që zotëron në masën prej 17.6 % të kapitalit themeltar.

Duke qenë se të dy ortakët kanë rënë dakord për shitjen e kapitalit të shoqërisë si më sipër palët hartojnë dhe nënshkruajnë këtë kontratë shit-blerje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë sipas parashikimeve si më poshtë vijon:

#### **Neni 1**

##### **OBJEKTI**

Objekt i kësaj kontrate është shitja e kuotës së kapitalit të shoqërisë "ITALDRURI ELBASAN" sh.p.k në masën prej 17.6 % të kapitalit themeltar, që zotërohen nga Ortaku i shoqërisë, shoqëria DIJON ALBANIA Sh.a., i cili paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre nga shoqëria ALAR Consulting sh.p.k., në cilësinë e blerësit.

#### **Neni 2**

##### **KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTËN**

Shitësi DIJON ALBANIA Sh.a. humbet pronësinë mbi masën prej 17.6 % të kuotës së zotëruar prej tij duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi pjesën e shitur të kapitalit.

Blerësi ALAR Consulting sh.p.k., bëhet pronar i kuotave në masën prej 17.6 % të kapitalit të shitur, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e këtij kapitali.

##### **Pronësia mbi kuotat do të kalojë në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.**

Pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, kapitali i shoqërisë do të zotërohet si vijon:

1. **Shoqëria DIJON ALBANIA sh.a.**, do të zotëroj 64.33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë, në vlerën prej 962,982,453 Leke.
2. **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**, do të zotëroj 18,07% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë, në vlerën prej 270,516,634 Leke.
3. **Shoqëria ALAR Consulting sh.p.k.**, do të zotëroj 17.6 % të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë, në vlerën prej 263,550,000.00 Leke.

#### **Neni 3**

##### **ÇMIMI I SHITJES SË KUOTËS**

Shitësi pranon se ka marrë nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rene dakord në vlerën 263,550,000 Leke, dhe për këtë arsye transferon këtu 17.6% të Kapitalit të

zoteruar nga Shitesi ne Kapitalin e Shoqerise "ITALDRURI ELBASAN" Sh.p.k., ne pronesi te Bleresit.

#### Neni 4

#### DISPOZITA TË FUNDIT

Kontrata hartohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën shqipe nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë.

Termat e kësaj kontrate, pasi u lexuan prej palëve kontraktuese, u gjetën sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë dhe ata e nënshkruajnë pa vërejtje.

#### PALËT

SHITËSI

DIJON ALBANIA sha

BLERËSI

ALAR Consulting shpk

Sulhona Poshako

